



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1709/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A me seli në Prishtinë, kundër debitorit Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.909/22 të datës 29.09.2023, me datë 21.03.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.909/22 i datës 29.09.2023, dhe çështja gjykohet si në vijim:

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit përmbarimor P.nr.922/21 datës 16.07.2021 i lejuar nga përmbaruesi privat Flamur Bogaj dhe Mbetet në fuqi Urdhri përmbarimor P.nr.922/21 i datës 16.07.2021 i lejuar nga përmbaruesi privat Flamur Bogaj nga Prishtina.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.909/22 të datës 29.09.2023, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina me seli në Prishtinë, dhe ka shfuqizuar Urdhrit Përmbarimor P.nr.922/21 të datës 16.07.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Flamur Bogaj në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-së, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tërësi si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar KPPP.nr.909/22 i datës 29.09.2023 të Shfuqizohet, dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor P.nr.922/21 i nxjerr nga përmbaruesi privat Flamur Bogaj.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale e mbeturinave “Pastrimi” Sh.A me seli në Prishtinë, me datën 16.17.2021 ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga librat afarist të kontabilitetit ID nr.127754, në shumë të përgjithshme prej 103,205.56€.

Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.922/21 të datës 16.07.2021 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Ekstraktit nga librat e Kontabilitetit, me të cilin ka obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 103.205.56€, për bartjen e mbeturinave, me kamatë prej 8% nga dita e lejimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet përmbartimore, në përputhje me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014 për Tarifat, Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbartuesit Privat, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në xhironlogarinë e tij bankare.

Debitori në prapësim të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor thekson se kreditori nuk ka paraqitur asnjë faturë për të cilën është fjala që nuk e ka kompensuar nga debitori, por ka paraqit vetëm listë të quajtur kartela e konsumatorit që përfshin periudhën 2012-2022 ndërsa në propozon ka kërkuar pagesën për vitin 01.01.2009-02.07.2021, ndërsa nga kartela e konsumatorit nuk ka paraqitur asnjë pagesë nga viti 2009 duke përmendur vetëm të mbetura nga kartela e konsumatorit, nuk posedon asnjë dëshmi të vetme faturë origjinale që ka lëshuar për debitorin, gjykatës i kërkon që të mos ekzekutohet propozimi për përmbartim pasi që nuk ka obligime të papaguara ndaj kreditorit.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, sepse kartela historike si dokument i besueshëm pasqyron gjendjen e borxhit të debitorit, nuk ka asgjë kontestuese në lidhje me faturimin e as në lartësinë e borxhit, sepse borxhi është akumuluar ndër vite, dhe deri te kjo situatë ka ardh vetëm si pasojë e mos përmbushjes se detyrimit nga debitori. Përgjigjes i bashkëngjisë kontratën për kryerjen e shërbimit të mbeturinave, gjykatës i propozon që të refuzon prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.909/22 datës 29.09.2023 me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina me seli në Prishtinë, dhe ka shfuqizuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.922/21 të datës 16.07.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Flamur Bogaj në Prishtinë.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, dhoma e shkallës së parë ka theksuar se ekstrakti i verifikuar nga librat afarist nr.127754, në bazë të së cilit është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson

kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 të LPP-së, për të qenë dokument i pranueshëm, për faktin se nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist. Meqenëse në këtë dokument nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit. Nga ekstrakti afarist rezulton se borxhi në shumën prej 103,205.56€ është kërkuar për periudhën kohore 01.01.2009 deri 02.07.2021 ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti nuk është përfshi periudha prej datës 01.01.2009 deri 31.12.2009 e as periudha për vitin 2010, me ç ‘rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhomat e shkallës së dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e dhomës së shkallës së parë.

Në këtë rast dhoma e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 29, 37 dhe nenin 71 par.1 pika 1.1 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike mbi atë çka përmbajnë shkresat në lëndë, e mbi të cilën mund të iniciohet procedura e përmbarimit.

Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se dokumenti i besueshëm - Kartela Financiare e Konsumatorit me shifër 127754, në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbarimore, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se kartela financiare e konsumatorit është lëshuar për periudhën 01.01.2009 deri 02.07.2021, në vlerë totale të borxhit prej 103,205.56€, andaj kartela financiare, është dokument i besueshëm, i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, si dhe i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.3, 1.4 të LPP-së, që parashohin:

Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;

Dhoma e shkallës së dytë nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e dhomës së shkallës së parë se kartela financiare e kreditorit në bazë të cilit është lejuar urdhri për përmbarim, nuk është dokument i besueshëm nga neni 29 paragrafi 1 të LPP-së. Kjo gjykatë vlerëson se dispozitat ligjore të lartcekura kartelën financiare në këtë rast të kreditorit, e përfshijnë si dokument të besueshëm në bazë të cilit realizohet përmbarimi, pasi që edhe kartela financiare me shifrën 127754 e kreditorit, duhet trajtuar si dokument publik, që është ekstrakt, evidencë e kreditorit për klientët,

që në këtë rast paraqet gjendjen e faturës së arkëtimit, shumën e borxhit, për secilin muaj, pagesat e borxhit nga debitori, borxhi i akumuluar për periudhën kohore 2009-2021, dhe vlera e borxhit e bartur për periudhën 01.01.2009.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Urdhri përmbarimor P.nr.922/21 datës 16.07.2021 i lejuar nga ana e Përmbaruesit privat Flamur Bogaj. Dhoma e shkallës së dytë nuk mund ta pranojë qëndrimin e dhomës së shkallës së parë, e cila në arsyetim të aktvendimit konteston përmbajtjen e kartelës financiare të kreditorit, për shkak se nuk është përfshi periudha e vitit 2009,2010. Kjo gjykate vlerëson se borxhi i mbledhur në total prej 103,205.56€ sipas kartelës financiare-ekstraktit të kreditorit, dhe propozimit për përmbarim, është borxh i akumuluar ndër vite nga periudha 01.01.2009, dhe përkundër faktit se debitori ka nënshkruar kontrat me kreditorin për kryerjen e shërbimeve, bartjen e mbeturinave dhe pagesat e shërbimeve brenda afatit të caktuar, detyrimi i pagesës së borxhit është akumuluar për shkak të mos pagesave nga debitori. Në prapësimin e debitorit datës 27.07.2021 nuk kundërshtohet kjo shumë e borxhit e akumuluar ndër vite, dhe debitori nuk paraqet dëshmi se ka përmbush detyrimin apo një pjesë të tij, për shërbimin, në emër të bartjes së mbeturinave sipas ekstraktit me shifër 127754.

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Kompetenca e Dhomës së shkallës së dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1709/23 datë 21.03.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha